



Raporti transparencës për vitin e mbyllur më 31.12.2024

1. Mesazh nga Partneri Drejtues.	2
2. Forma Ligjore dhe Struktura e Pronësisë.	3
3. Struktura Organizative dhe Udhëheqja	3
4. Sistemi i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë.	3
5. Informacioni mbi kontrollin e fundit të cilësisë.	6
6. Deklarata praktikave të pavarësisë.	6
7. Lista e njësive ekonomike me interes publik.	6
8. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.	7
9. Informacioni Financiar.	7
10. Bazat e shpërblimit të ortakëve të angazhimit.	8
11. Përfundimi dhe Informacioni i Kontaktit	8

Egin Koçollari
Partner Angazhimi &
Auditues Ligjor

www.thinksmart.al
ekocollari@thinksmart.al
+355 69 600 55 66

1. Mesazh nga Partneri Drejtues.

Pershendetje partnere, kliente dhe pale te interesuara,
Jam i lumtur t'ju prezantoj raportin tone te pare te transparences.
Me themelimin e Thinksmart A & C SHPK me 18 Nentor 2024,
ne kemi per qellim te vazhdojme traditen e integritetit, cilesise
dhe profesionalizmit ne fushen e auditimit dhe keshillimit, ne
vijim te aktivitetit te Egin Kocollari PF. Si partner dhe
administrator i vetem, une, Egin Kocollari, jam i angazhuar te
siguroj qe cdo aktivitet dhe vendim profesional te ndermerret
sipas standardeve me te larta te etikes dhe cilesise.

Ndryshimet me te fundit ligjore, se bashkur me standarde te reja
te perdituesara, kane ndikuar ndjeshem ne ambientin
profesional. Per vitin 2024, kompania jone ka nenvizuar kerkesat
e reja ligjore, duke perfshire Ligjin nr. 126/2024 (date
19.12.2024) perdise shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 10 091
(date 5.3.2009) per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te
audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar. Keto ndryshime,
bashke me aktivitetin e shtuar rregullator nga institucionet
mbikeqyres, kane sjelle nje rritje te dukshme te pergjegjesise
dhe te standardeve operative, duke siguruar perputhje te plote
me kerkesat ligjore dhe etike.

Ne kemi permiresuar proceset tona te auditimit per te arritur
standarde te larta cilesie, duke zbatuar kerkesat e vendosura
nga IEKA dhe BMP, dhe duke vendosur politika te rrepta per
pavarsine. Ne besojme se nje praktike e auditimit qe reflekton
transparence, integritet dhe perkushtim ndaj etikes kontribuon
ne ruajtjen e integritetit te profesionit dhe ne rritjen e besimit nga
ana e klienteve. Ky raport i transparences pasqyron angazhimin
tone per te siguruar qe cdo angazhim audituese te kryhet ne
perputhje me kerkesat ligjore dhe rregullatore, duke nxit
permiresime te vazhdueshme dhe duke forcuar lidhjet tona me
interesin publik.

2. Forma Ligjore dhe Struktura e Pronësisë.

- **Forma Ligjore:** Thinksmart A & C SHPK është një kompani me përgjegjësi të kufizuar (Shpk) me emër tregtar Thinksmart-Audit & Consultancy Services.
- **Data e Themimit:** 18 Nëntor 2024.
- **Regjistrimi:** Shoqëria është regjistruar në regjistrin e audituesve ligjore të IEKA sipas vendimit nr. 979, datë 06.12.2024.
- **Pronësi:** Partneri dhe administratori i vetëm është Egin Koçollari, i cili më parë e ka zhvilluar aktivitetin e tij si auditues ligjor në formën e personit fizik me NIPT L92208012B.

3. Struktura Organizative dhe Udhëheqja

Si një firmë me një strukturë të thjeshtë organizative, Thinksmart A & C SHPK operon në mënyrë të drejtpërdrejtë nën drejtimin e:

- **Partneri dhe Administrator:** Egin Koçollari.
- **Organizimi i Punës:** Duke qenë një kompani e re dhe me një partner të vetëm, menaxhimi i proceseve të përditshme, vendimmarrja strategjike dhe mbikëqyrja e aktiviteteve kryesore kryhen direkt nga administratori, duke siguruar një qasje të personalizuar dhe fleksibile ndaj klientëve dhe projekteve të auditimit.

4. Sistemi i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë.

Thinksmart A & C SHPK ka ngritur një sistem të avancuar të kontrollit të cilësisë, i bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare (standardet ISQM1 dhe ISQM2 të implementuara në fund të vitit 2022 dhe të rishikuara në fund të vitit 2023. Gjatë Vitit 2024 nuk pati ndryshime në këtë sistem pas rishikimit të fundvitit), për të garantuar që çdo angazhim auditues të kryhet me saktësi, në përputhje me kërkesat ligjore, rregullatore dhe standardet profesionale.

Ky sistem është projektuar me një qasje të bazuar në rrezik, ku çdo hap – nga pranimi i klientëve deri te dokumentimi përfundimtar – përmban masa të rrepta kontrolli dhe monitorimi.

- **Qeverisja dhe përkushtimi ndaj cilësisë (Tone at the top)**

Thinksmart ka krijuar një kulturë organizative që vendos cilësinë në qendër të veprimtarisë së saj. Kjo përfshin:

- Përkushtim të qartë ndaj cilësisë në të gjitha nivelet e shoqërisë.
- Zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe veprim shërbimesh me interes publik.
- Vlera të forta etike dhe profesionale.
- Përgjegjësi e të gjithë stafit për cilësinë dhe sjellje të pritshme profesionale.
- Marrje e vendimeve strategjike me fokus cilësinë dhe mbështetje me burime financiare.
- Drejtuesit janë përgjegjës dhe japin llogari për cilësinë.
- Struktura e organizatës është ndërtuar për të mbështetur dhe zbatuar sistemin e cilësisë.
- Menaxhimi i kujdesshëm i burimeve (financiare, teknologjike, njerëzore) për të arritur qëllimet e cilësisë.

- **Zbatimi Kodit të Etikës.**

Në bazë të këtij sistemi, zbatimi i Kodit të Etikës shërben si themel i fortë, duke siguruar që integriteti, pavarësia, objektiviteti dhe konfidencialiteti të jenë parimet themelore në çdo aktivitet por pa nënvlerësuar zbatimin e saktë të standardeve, si dhe dokumentimin. Politikat tona të brendshme përcaktojnë qartë rolin e drejtimit dhe mbikëqyrjes, duke përfshirë këshillimin nga kolegë me përvojë, azhurnimin periodik të procedurave dhe dokumentimin e plotë të çdo faze të procesit.

- **Pranimi dhe vazhdimi i klientit.**

Proceset tona për pranimin dhe vazhdimin e klientëve përfshijnë një vlerësim të detajuar të besueshmërisë së entiteteve audituese – duke analizuar reputacionin, strukturën organizative dhe aftësinë për të përmbushur standardet e kërkuara. Në rastin e identifikimit të rreziqeve, aplikohen procedura të veçanta për të siguruar një angazhim të vazhdueshëm dhe, kur është e nevojshme, për të dokumentuar dhe menaxhuar tërheqjen e angazhimit, gjithmonë me konsultime ligjore të detajuara. Disa prej kritereve kryesore për pranimin vazhdimin e angazhimit janë:

- Klientë që veprojnë me integritet, në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikueshme, përfshirë kërkesat e parandalimit të financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave.
- Në pranimin e klientit zbatohen politikat e etikës dhe pavarësisë, dhe çdo

klient i cili është i ndaluar nga këto politika refuzohet.

Në aspektin e kryerjes së punës audituese, çdo kontrol i ndërmarrë realizohet nga ekipe të specializuara, duke përfshirë këshillimin e brendshëm, mbikëqyrjen gjatë ekzekutimit, dhe dokumentimin e hollësishëm. Këto masa janë thelbësore për të garantuar se raportet dhe rezultatet e auditeve përmbushin kërkesat e cilesisë dhe reflektojnë një transparencë të plotë. Gjatë procesit të pranimit të klientit, partneri që do të angazhohet, vlerëson gjithashtu nivelin e rrezikut të angazhimit dhe përcakton nëse përmbushen kërkesa për personel të specializuar, mbikëqyrje dhe rishikim. Sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator edhe të standardeve të menaxhimit të cilësisë për çdo angazhim në auditimin e njësive ekonomike me interes publik caktohet rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit.

- **Administrimi burimeve njerëzore.**

Administrimi i burimeve njerëzore është një komponent kyç i sistemit tonë. Ne zbatojmë politika të qarta për rekrutimin, vlerësimin e performancës, zhvillimin profesional, promovimet, shpërblimet, planifikimin e numrit të stafit dhe trajnimet e vazhdueshme. Këto masa sigurojnë që ekipi ynë të jetë gjithmonë i përgatitur për të përballuar sfidat e auditimit modern dhe për të garantuar një cilësi të lartë të shërbimeve.

5

- **Tërheqja nga angazhimi/ndërprerja marrëdhënies me klientin.**

Kur merret në shqyrtim ndërprerja e një angazhimi ose e marrëdhënies me një klient, ndiqen këto hapa:

- Fillimisht, partnerët do të zhvillojnë takime me përfaqësuesit e klientit si dhe me përfaqësues të qeverisjes korporative, për të diskutuar veprimet e mundshme që mund të ndërmerren, duke marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat specifike të çështjes.
- Nëse pas analizës vlerësohet se ndërprerja është e justifikuar, kompania do të përpilojë dokumentacionin përkatës që përmbledh arsyet kryesore që çuan në vendimin për tërheqje. Ky dokumentim do të përfshijë gjithashtu rezultatet e konsultimeve të bëra dhe përfundimet e nxjerra mbi këtë bazë. Gjithashtu, do të shqyrtohet nëse ekziston ndonjë detyrim profesional, ligjor apo rregullator për të informuar autoritetet përkatëse mbi vendimin për tërheqje.
- Në rast se ekziston një detyrim ligjor, rregullator apo profesional që e detyron shoqërinë të vazhdojë angazhimin, atëherë duhet të dokumentohen qartë arsyet për këtë vazhdimësi, duke përfshirë edhe këshillat e marra nga juristët apo ekspertët ligjorë.

Ky mekanizëm i avancuar i kontrollit të cilësisë pasqyron angazhimin tonë ndaj transparencës, integritetit dhe inovacionit, duke garantuar që çdo angazhim auditimi të realizohet në mënyrë efikase dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore, ndërsa forcon besimin e klientëve dhe mbron interesin publik

5. Informacioni mbi kontrollin e fundit të cilësisë.

Autoriteti mbikëqyrës për cilësinë e auditimit është Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Gjatë vitit 2024 shoqëria nuk ka qenë subjekt i kontrollit për sigurimin e cilësisë ashtu si edhe audituesi ligjor Egin Koçollari.

6. Deklarata praktikave të pavarësisë.

Ne jemi të pavarur nga klientët tanë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi iBSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme në Shqipëri duke përfshirë kodin e etikës së IEKA-s, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

6

7. Lista e njësive ekonomike me interes publik.

Lista e njësive ekonomike me interes publik, për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit të fundit nga shoqëria e auditimit

Në zbatim të pikës 23, nenit 2 të Ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.01.2019, "Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin publik, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre", i ndryshuar, njësitë ekonomike me interes publik klasifikohen si vijon:

- ✓ Të gjitha njësitë ekonomike të listuar në bursë.
- ✓ Bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jo banka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
- ✓ Shoqëritë e sigurimit dhe të ri sigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar.
- ✓ Shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin

e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2024, shoqëria ka audituar Shoqëritë e mëposhtme me interes publik:

“OSHEE GROUP” SH.A dhe “KESH”SH.A.

8. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.

Partnerët dhe stafi i Thinksmart kanë detyrimin të ndjekin kërkesat minimale për zhvillim të vazhdueshëm profesional, në përputhje me rregulloret e organizatës profesionale të audituesve ligjorë në Shqipëri (IEKA).

Partneri I angazhimit, AL I angazhuar ne shoqëri ndjek programe të vazhdueshme kualifikimi të organizuara nga IEKA, ndërsa punonjësit e tjerë të shoqërisë marrin pjesë në trajnime sipas nivelit të tyre, përmes trajnime fizike kur ka mundësi, platformave online, webinarëve apo formave të tjera, të planifikuara në një kalendar vjetor trajnimesh.

Thinksmart përpiqet për të rritur kompetencat profesionale të stafit tonë, përmes programeve të trajnimit që janë të përshtatura me detyrat dhe nevojat e tyre zhvillimore. Procesi përfshin gjithashtu vlerësimin e performancës dhe identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim.

Kultura organizative inkurajon bashkëpunimin dhe konsultimin në ekip, veçanërisht për çështje komplekse që kërkojnë analizë të thelluar. Kjo qasje ndihmon në zhvillimin e njohurive kolektive, forcimin e kontrollit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale.

9. Informacioni Financiar.

Të ardhurat e shoqërisë për vitin e mbyllur më 31.12.2024 analizohen si më poshtë:

Të ardhurat	Viti mbyllur më 31.12.2024/000 ALL
Të ardhurat nga shërbime auditimi	3,676
Të ardhurat e tjera	36,6
Totali	3,713

10. Bazat e shpërblimit të ortakëve të angazhimit.

Shpërblimi i partnerëve në Thinksmart bazohet në faktorë të tillë si:

- Cilësia e punës së kryer;
 - Kontributi në menaxhimin dhe zhvillimin e firmës;
 - Performanca individuale dhe kolektive.
-

11. Përfundimi dhe Informacioni i Kontaktit

Ne jemi të përkushtuar për transparencë, cilësi dhe integritet në çdo aktivitet të kompanisë. Ky raport pasqyron përkushtimin tonë për të ndërtuar një marrëdhënie të fortë besimi me klientët dhe partnerët tanë.

- **Kontakti:**
 - **Emri:** Egin Koçollari
 - **Roli:** Partner Menaxhues dhe Administrator
 - ekocollari@thinksmart.al
-